

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 24 MARS 2022

Zonja drejtuese e seancës,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë dhe qytetare të vendit,

Fatkeqësitë për individët, për kombet, janë zhvillimet më të padëshiruara, por ato shndërrohen në dramë më të vërteta për kombet dhe shoqëritë kur kanë në krye një qeveri që në çdo hap, në çdo zhvillim, në çdo moment të saj, ka dorën e vetë të zezë, gishtin e vetë të zi. Të dashur qytetarë dhe qytetare, Keni parë këto ditë ministra që vrapojnë nëpër dyqane për t'ju gënjyer juve se u qan zemra nga çmimet e rritura, spekulime të lidhura direkt me xhepin dhe kontot e tyre. Keni dëgjuar ministra dhe vetë Kryeministrin të rrahë gjoksin për suksesin në luftën kundër COVID-it, duke shpallur mbi 20 mijë të vdekur, një numër kaq të lartë sa në asnjë vend tjetër të Europës, një numër kaq të lartë sa gjendet vetëm në 3-4 vende të botës. Ata janë njerëz, nuk janë numra. Janë nëna, baballarë, fëmijë, gjyshër dhe gjyshe, të cilët ikën. Vërtet Covid-i është edhe vdekjeprurës në disa raste, por pse në Shqipëri të jetë 3 herë më vdekjeprurës se në Bashkimin Europian? Pse në Shqipëri të jetë më vdekjeprurës se në çdo vend tjetër evropian?

Kjo vdekshmëri ka në bazë vetëm vjedhjen, papërgjegjshmërinë, cinizmin, shpirtkazmërinë, sepse këta njerëz nuk shtroheshin. Kosova dhe Maqedonia kishin 3 herë më shumë shtrime në spitale, për të mos folur për vende të tjera, kurse këtu tregoheshin filma me kodra me të vdekur e të tjera. Fatkeqësitë u shton edhe drama dhe tragjedi kjo qeveri. Një gjë duhet të dini, që hajduti ka vetëm refleksin e vjedhjes, nuk ka ndjenja. Kalojmë tek energjia. Lajmëtari, lajmkeqi i parë i rritjes së energjisë, është vetë kreu i qeverisë. E them dhe do ta them sërish. Nuk ndodh në botë të bëhet zëdhënës i kompanive të naftës pa pasur aksione të veta në ato kompani. Jam plotësisht dakord që tregu i naftës ka pësuar një goditje nga lufta në Ukrainë, por problemi është se në Shqipëri, si në asnjë vend tjetër, nafta ka 4 taksa, 3 tarifa, dhe për naftën i paguhet 1 euro taksë shtetit, qeverisë. Italia sot e hoqi akcizën. 13 vende të tjera të Bashkimit Europian kanë hequr taksat mbi naftën. Disa edhe i kanë hequr. Sot Italia i uli në mënyrë të ndjeshme. Çfarë është kjo kokëfortësi e tmerrshme: - "Nuk i lëviz dot taksat unë"? Ku ndodh kjo? Nëse ju do të kishit ndjenja, merrni lexoni, sepse Eurostar, Brykel dhe institute të tjera serioze tregojnë të gjitha masat e marra. Këto që unë po them janë bërë para lufte.

Do të kalojmë në një moment tjetër. A e dini ju që Shqipëria ka energjinë me koston më të ulët në Europë? Po, sepse është energji ujore pothuajse e gjitha. A e dini ju që viti 2021 është viti kampion i prodhimit të energjisë në Shqipëri? Janë prodhuar 8,9 terravatë. 5,3 terravatë është konsumi tarifor. A e dini çfarë ndodh, apo jo? Janë eksportuar terravatë të tërë. Kush e di çmimin? Hajdutët e mbajnë sekret. KESH-i nuk publikon çmimet me të cilat ka eksportuar energjinë. Jua them unë: ka eksportuar në verë, ka zbratur kaskadën në mënyrën më kriminale, në kundërshtim me ligjet e vendit, në kundërshtim me ligjet

e rezervës energjetike e të tjera, 29 metër thellësi ka zbratur kaskadën e ujit në Fierzë. Sa e kanë shitur? 40 euro. Sa ishte në bursë? 130 euro. Ky që e blinte 40 euro, e shiste sërish 130 euro dhe këto para i ndante me ministrin, Kryeministrin apo me zyrtarin. Ç'lidhje ka energjia elektrike me naftën? Nuk ka lidhje. Është energji ujore me koston më të ulët.

Të kalojmë më tej, tek ushqimet. Çfarë ndodh me ushqimet? Çdo shtet ka rezervën strategjike të naftës, të grurit, të miellit. Këtu janë të gjitha në oborrin e Kryeministrit, zotërinj. Unë nuk kam asnjë xhelozë për lidhjet e tij. Sigurisht, aty ku flitet dhe dyshohet për aksione, përbën fatkeqësi të madhe kombëtare dhe vepër kriminale, nëse është, por nuk mund ta pranojë që importuesi numër 1 i grurit të mos jetë njëkohësisht garantuesi i grurit të paktën për 2 muaj në silloset e tij. Unë nuk mund të pranoj që prodhuesi kryesor i miellit të mos ketë në silloset e tij të paktën 3 muaj miell, siç ka Kosova, nuk po them siç ka Gjermania apo Franca. Qytetarë, a i shikoni ju inspektorët që dalin nëpër dyqane, sepse po ju qajnë hallin juve për çmimet? Këta ndonjë ditë do të vendosin në faqe lot artificiale për t'ju treguar se po qajnë për ju. Ku kanë zemër këta? Këta kanë zemër vetëm për para, për asgjë tjetër.

Së fundi, na sollën edhe gripin e pulave, duke shkelur sërish çdo ligj, sepse mbahej sekret qeveritar një sëmundje, e cila duhej të deklarohet kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht sipas ligjeve, sepse përbën problem jo vetëm për vendin, por edhe për rajonin, por është deklaruar vetëm, në mos gaboj në muajit qershor – korrik të vitit 2021 për herë të parë. U deklaruan atëherë kur u sakrifikuan miliona pula. Po njerëzit? Duhej të mbahej e fshehtë, le të sëmureshin njerëzit, le të vdisnin nga epidemia e gripit të shpendëve, nuk kishte rëndësi, mjafton të ruhej reputacioni i qeveritarëve! Çfarë po ndodh me bujqësinë, e cila është më e braktisura? Çfarë janë ato 300 lekë që u jepni njerëzve? Ato nuk mjaftojnë as për bukën, me rritjen e çmimit të bukës, kjo është tallje. Kjo krizë ka afrim të thellë, nuk është afatshkurtër. A bëtë ndonjë stimulim të mbjelljeve të lastrave të misrit këtë pranverë? Llafe, llafe, llafe. Në vend që të ndiqnit të paktën shembullin e Kosovës, e cila subvencionoi çdo hektarë të mbjellë me 420 euro, ju vini dhe recitoni këtu.

Çdo gjë e ka një kufi dhe nuk duhet ta tejkaloni. Jeni fajtor para shqiptarëve për të gjitha këto zhvillime; jeni fajtor, sepse keni dorë në të gjitha këto zhvillime që po ndodhin. Pasuroheni natën mbi mjerimin e shqiptarëve. Prandaj po e mbyll këtë fjalë, duke u bërë thirrje qytetarëve shqiptarë: kjo pranverë duhet të jetë pranvera e protestave të mëdha.